




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0005630-13/26, dt. 10.02.2026
Mitrovicë



Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, qershor 2008); nenet: 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 73, të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; nenin 9, të Rregullores Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë; Kuvendit të Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 10.02.2026 sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave

1. FORMOHET Komisioni i Ankesave për ndarjen e bursave në këtë përbërje:
 - 1.1 Nazmije Sejdiu,
 - 1.2 Bajram Istrefi,
 - 1.3 Alban Fejzullahu,
 - 1.4 Albana Kastrati Rama, dhe
 - 1.5 Edin Lahu (nga shoqëria civile).
2. Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë ankesat, lidhur me konkursin për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara me konkurs dhe në harmoni me Rregulloren Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë.
3. Komisioni ka tridhjetë (30) ditë kohë nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesave, të marr vendim lidhur me ankesën dhe të njëjtin t'ua dorëzoj me shkrim secilit parashtrues të ankesës.
4. Vendimi i Komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurë administrative.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës, Kryesuesja e Kuvendit dhe Komisioni i formuar me këtë vendim.
6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL-së

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Anëtarëve të emëruar